




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 210/01-26675 /2018
Kaçanik, 13.08.2018

Në bazë të nenit 5 pika (c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018 Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, rishpallë:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të lirë të punës
për vitin shkollor 2018/2019.

Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „7 Shtatori” në Bëgracë
Një mësimdhënës i mësimit klasor (me kohë të caktuar)

Detyrat dhe përgjegjësitë për vendin e punës të shënuar më lartë :

- Të realizoj planprogramin mësimor , në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës dhe të kryejë me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të Shkollës;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ia caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Kushtet e pjesëmarrjes në Konkurs:

Për vendin e punës të shënuar më lartë, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it.Nr.10/2018 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin si në vijim: diploma e fakultetit përkatës, ekstrakti i lindjes, vërtetim për përvojën e punës në arsim dhe kopjen e letërnjoftimit. Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje, ndërsa origjinali duhet të sjellët në ditën e intervistimit.

Afati dhe mënyra aplikimit.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar-Zyra e Pranimit, kati përthës.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes, postës elektronike (e-mail) ose tabelës së shpalljeve publike.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 14.08.2018 deri 28.08.2018.



Drejtori i drejtorisë
L. Zahir Doda